



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Analizë e politikave 07/2019

Mbyllja e kundërligjshme dhe arbitrare e seancave gjyqësore për publikun në çështjet penale

Analizë e legjislacionit dhe praktikës së GjEDNj rreth natyrës publike të seancave gjyqësore dhe praktikës së mbrapshtë të krijuar nga Sistemi i Drejtësisë në Kosovë

Autorët: Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Gusht 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	4
2.	Natyra publike e seancave gjyqësore në sistemin juridik të Republikës së Kosovës.....	6
2.1.	Legjislacioni i brendshëm	6
2.1.1.	Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	6
2.1.2.	Kodi i Procedurës Penale	7
2.2.	Instrumentet Ndërkombëtare.....	8
2.3.	Praktika e GjEDNj	9
3.	Praktikat e mbrapshta të gjykatësve të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës	11
3.1.	Mbyllja e kundërligjshme e seancave publike	11
3.2.	Mbyllja arbitrare e seancave publike	14
3.3.	Gjykatësi në rolin e Prokurorit, nuk lejon xhirimin e seancës me arsyetimin se rrezikohet administrimi i drejtë i procesit gjyqësor	15
3.4.	Praktika e kundërligjshme e disa gjykatave për përjashtimin e publikut nga seancat dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë	18
4.	Mbyllja e gjykimeve si demantim i premtimit dhe të arriturave për transparencë.....	19
5.	Heshtja e akterëve të sistemit të drejtësisë përballë këtij fenomeni	19
6.	Konkluzione.....	21
7.	Rekomandime	22

1. Përmbledhje ekzekutive

Sistemi i drejtësisë vazhdimisht ka qenë subjekt i kritikave për mos transparencë dhe llogaridhënie publike, përkundër faktin se akterët brenda sistemit të drejtësisë vazhdimisht proklamoni se puna e tyre bazohet në këto parime. Në këtë drejtim, përpos pikave të tjera në të cilat sistemi i drejtësisë dështon në zbatimin e parimit të transparencës, IKD gjatë procesit të monitorimit sistematik të seancave gjyqësore në fushën penale, ka evidentuar raste të mbylljes së kundërligjshme dhe arbitrare të seancave të caktuara gjyqësore, informimi për të cilat është i rëndësishëm për publikun, mediat dhe shoqërinë civile.

Në aspektin legjislativ Kosova ka arritur të përafrojë kornizën ligjore lidhur me transparencën dhe publicitetin e punës së gjykatave, në pajtim me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë apo në të cilat Kosova aspiron për tu anëtarësuar në të ardhmen, si ai i shteteve të Bashkimit Europian. Në këtë drejtim, praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), jurisprudenca e së cilës në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës është e obligueshme, ka vendosur standarde në këtë fushë.

Në rastin *Malhous* kundër Republikës së Çekisë, GjEDNj ka theksuar rëndësinë që seancat gjyqësore të jenë publike: *“Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ. Ky karakter publik i mbrojtjes ndërgjyqësore kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, garancion, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ”*. Raste të tjera të shumta të GjEDNj kanë vendosur standarde shumë specifike që duhet një gjyqtar të aplikoj me rastin e vendosjes se seanca a do të jetë e hapur apo e mbyllur për publikun. Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, këto standarde të GjEDNj janë obligative për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Përpos KEDNJ-së, edhe Karta Europiane për të Drejtat Themelore (KEDTh) përcakton shprehimisht se gjykimi duhet të jetë publik. Një ndër rrugët kryesore të Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian është edhe Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Në këtë marrëveshje, përafrimi i legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Europian (BE) është njëra ndër kategoritë themelore të kësaj marrëveshje. Ndër të tjera, kjo marrëveshje përcakton se “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me Acquis-in e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet

siç duhet”¹. Për këtë arsye, përafrimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe zbatimi i tij me atë të BE-së, është një kusht i domosdoshëm i Republikës së Kosovës për avancim të mëtutjeshëm në rrugën drejt BE-së.

Ndonëse, siç e pamë më lartë, dispozitat ligjore si ato vendore dhe ndërkombëtare dhe po ashtu edhe praktika e GjEDNj i japin rëndësi jetike proceseve gjyqësore të hapura për publikun dhe palët e interesuara, për të siguruar një proces gjyqësor të drejtë, që qëllim final ka fitimin e besimit të publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave, gjykatësit e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës rezulton se ende nuk janë të përgatitur dhe nuk kuptojnë obligimet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë fushë. Kjo për arsye se një numër i caktuar i seancave të natyrës penale në sistemin gjyqësor që IKD i monitoron sistematikisht, mbyllet për publikun nga ana e gjykatësve, dhe në raste të tilla, publiku, media dhe shoqëria civile nuk marrin vendimin për mbylljen seancave gjyqësore, përderisa jo rrallë arsyetimi në vendim është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në Kushtetutë dhe KPPK. Sa i përket seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë, disa prej gjykatave kanë krijuar një praktikë të kundërligjshme, duke i cilësuar këto seanca si parimisht të mbyllura, dhe duke krijuar laramani në trajtimin e kësaj çështje brenda gjykatave të Republikës së Kosovës.

Ndonëse nga mediat dhe shoqëria civile raportohet për mbyllje të seancave të caktuara në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare për të cilat publiku është i interesuar të informohet, të gjithë akterët brenda sistemit të drejtësisë heshtin përballë këtyre rasteve.

IKD bënë me dije se fakti se një gjyqtar i caktuar ka pavarësi në vendosje nuk e bënë atë imun ndaj vendimeve të kundërligjshme për mbylljen e seancave që me ligj janë publike, e aq më tepër ndaj rasteve kur të njëjtit përjashtojnë publikun dhe mediat në mënyrë plotësisht arbitrare, pa marrë asnjë lloj vendimi formal.

IKD vlerëson se publiciteti i seancave gjyqësore duhet të kuptohet në atë formë që në asnjë rrethanë nuk e dëmton administrimin e drejtësisë. Në të kundërtën, siç e përcakton edhe praktika e GjEDNj, ajo i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur dhe është një nga mënyrat me anë të së cilës mbahet besimi në gjykata. Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se publiciteti i seancave gjyqësore, sipas KEDNj, është një nga elementet që formëson të drejtën për një proces të rregullt.

Po ashtu, transparenca e sistemit të drejtësisë nuk është një fakt i mirëqenë, i cili mund të proklamohet në mënyrë të përgjithësuar. Për vlerësimin e transparencës, ka matës shumë specifik. Sa i përket sistemit gjyqësor, mos transparenca më e madhe paraqitet në rastet kur publiku përjashtohet nga përcjellja e seancave gjyqësore, të cilat sipas ligjit janë të hapura, dhe për të cilat publiku ka interes që të informohet.

¹ Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit ndërmjet Kosovës*, në njëërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër. Neni 74. (shih linkun https://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo-eu_saa_final_sq.pdf). (Qasur së fundi më 22 korrik 2019).

2. Natyra publike e seancave gjyqësore në sistemin juridik të Republikës së Kosovës

Një prej attributeve kryesore të gjykimit është ajo se i njëjti parimisht duhet të jetë publik. Ky atribut i gjykimit përcaktohet përkrah attributeve të tjera të pakta me të cilat edhe cilësohet gjykimi i drejtë. Si shembull për këtë merret Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e cila përcakton se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, **publikisht** dhe brenda një afati të arsyeshëm...”. Pra, “**publikisht**” në këtë rast është një nga tri atributet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt.

Në anën tjetër, praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare ndërkombëtarë, si dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës përcaktojnë detyrueshmërinë që seancat parimisht të jenë të hapura për publikun. Në këtë drejtim, rol kyç ka Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) me anë të jurisprudencës së saj, e cila në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës është e obligueshme, ka vendosur standarde në këtë fushë.

Në vijim do të trajtohen obligimet e sistemi të drejtësisë në Republikën e Kosovës që seancat të jenë publike, duke trajtuar edhe jurisprudencën e GjEDNJ.

2.1. Legjislacioni i brendshëm

2.1.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, garanton të *drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm*². Për më tepër, Kushtetuta përcakton garanci ligjore në obligimin e gjykatave për të siguruar gjykim publik. “*Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj*”².

Për këtë arsye, publiciteti i seancave gjyqësore është një parim kushtetues, mos respektimi i të cilit parim automatikisht nënkupton shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 31

2.1.2. Kodi i Procedurës Penale

Në anën tjetër, edhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) është në të njëjtën linjë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i cili ndërton parimin se *“Shqyrtimi gjyqësor është i hapur”*.

Përfundimisht, KPPK, ka paraparë situatat, kur gjykatësit mund të përjashtojnë publikun publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për:

- 1.1. Ruajtjen e fshehtësisë zyrtare;
- 1.2. Ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur;
- 1.3. Ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit;
- 1.4. Mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- 1.5. Mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose
- 1.6. Mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi”.

KPPK në pajtim me dispozitën kushtetuese lidhur me publicitetin e seancave gjyqësore, ka ndërtuar standartin se në parim gjykimi është publik, derisa përjashtimet nga ky parim janë përcaktuar me enumeracion pozitiv, pasi gjykimi mund të mbyllet ekskluzivisht vetëm në rrethanat e përcaktuara në nenin 294, dhe jo edhe për arsye të tjera.

Tutje, KPPRK përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin e parasheh si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale. Neni 384 i KPPRK-së përcakton se “shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: ...1.4 publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin”. Ndërsa, në bazë të nenit 402, paragrafi 1.1 të KPPRK-së, Gjykata e Apelit e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën e kthen në rivendosje nëse konstaton se ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Nga kjo kuptohet se kjo shkelje është një shkelje e një niveli të lartë, për të cilën Gjykata duhet të ketë vëmendje dhe kujdes të shtuar gjatë gjithë procedurës, dhe jo ta trajtojë si një çështje dytësore, pasi e njëjta mund të ndikojë edhe në anulimin e tërësishëm të një procesi gjyqësor.

2.2. Instrumentet Ndërkombëtare

Monitorimi dhe publikimi i proceseve gjyqësore nga mediat dhe publiku është e drejtë, e cila hyn në kuadër të së drejtës së lirisë së mendimit dhe të shprehurit.

Neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut sanksionon të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, sipas të cilit nen, *“kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë”*.

Edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përcakton shprehimisht se gjykimi duhet të jetë publik. Në nenin 6 të KEDNJ-së përcaktohet se *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, **publikisht** dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj....”*.

KEDNJ-së përcakton specifikisht rastet kur seanca gjyqësore mund të mbahet si e mbyllur. Në këtë kuptim, neni 6 i KEDNJ-së përcakton se *“prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”*.

Përpos KEDNJ-së, edhe KBEDTh e sanksionon shprehimisht gjykimin publik. Sipas kësaj karte, *“Çdokush ka të drejtë në një seancë të drejtë dhe publike brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”*³.

Në anën tjetër, Lirinë e shprehjes e garanton edhe neni 10 i KEDNJ-së, sipas të cilit nen *“kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë”*.

Edhe KEDNJ përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në rrethana specifike të cilat në bazë të enumeracionit taksativ janë të përmendura në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës. Ky paragraf përcakton se *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të **nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor**”*.

³ Charter of Fundamental Rights of the European Union. 18.12.2000. Neni 47. (Shih linkun https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf). (Qasur së fundi më 22 korrik 2019).

Janë edhe një numër i madh i instrumenteve ndërkombëtare që flasin për këtë çështje, por esenca e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe KEDNJ-së është se në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të njëjtat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

2.3. Praktika e GjEDNJ

Kushtetuta e Republikës së Kosovës për interpretimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ka përcaktuar si pikë referencë praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ). Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Në jurisprudencën e saj GjEDNJ ka një mori rastesh në të cilat edhe ka vendosur standarde lidhur me publicitetin e seancave gjyqësore, standarde të cilat në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duhet të zbatohen nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Në rastin *Malhous kundër Republikës së Çekisë*, GjEDNJ ka theksuar rëndësinë që seancat gjyqësore të jenë publike:

“Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ. Ky karakter publik i mbrojtjes palët ndërgjygjëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, garancion, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ⁴.”

Në rastin *Allan Jacobsson kundër Suedisë*, GjEDNJ ka përcaktuar se për të ju shmangur mbajtjes publike të seancës gjyqësore, duhet të ekzistojnë rrethana përjashtësuese:

“GjEDNJ rikujton që sipas praktikës së saj gjyqësore, në një procedurë këtu, para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për mbajtjen publike të seancës sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ, nënkupton të drejtën për një seancë dëgjimore, përveç nëse ekzistojnë rrethana përjashtësuese të jashtëzakonshme që justifikojnë përjashtimisht e një dëgjimit të tillë”⁵.

⁴Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Malhous kundër Republikës Çeke*. Aktgjykim. Strasburg. 12 korrik 2001. Paragrafi 55-56. (Shih linkun <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-59590>). (qasur së fundi më 16 maj 2019)

⁵Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Allan Jacobsson kundër Suedisë*. Aktgjykim. Strasburg. 19 shkurt 1998. paragrafi 46. (Shih linkun [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-58133%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-58133%22]})). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

Qëndrim të njejtë si në këtë rast GjEDNj ka pasur edhe në rastet GÖÇ kundër Turkisë⁶ dhe Fredin kundër Suedisë⁷.

Ndërsa, sa i përket procedurës para gjykatës së shkallës së dytë apo të tretë, GjEDNj në rastin Helters kundër Suedisë ka përcaktuar se nga veçoritë e veçanta të procedurës në fjalë dhe me kusht që shqyrtimi publik të jetë mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, mungesa e shqyrtimit publik mund të arsyetohet⁸.

Në lidhje me përjashtimin ose mos përjashtimin e mediave dhe publikut nga një seancë gjyqësore, GjEDNj ka përcaktuar se për këtë rrethanë Gjykata do ta përcaktojë duke analizuar rrethanat e secilit rast veç e veç⁹.

Sipas GjEDNj, kufizimi i gjykimit për publikun dhe mediat, në rastet e përcaktuara, duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar. Kjo Gjykatë, në rastin Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë ka theksuar se:

“Megjithatë, Gjykata edhe më parë ka konstatuar se prania e thjeshtë e një informacioni të kualifikuar në shkresat e lëndës nuk nënkupton automatikisht nevojën e mbylljes së gjykimit për publikun, pa vlerësuar domosdoshmërinë për mbylljen e gjykimit, përmes peshimit të parimit që seancat duhet të jenë publike dhe nevojën për të mbrojtur rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Prandaj, para përjashtimit të publikut nga një pjesë e caktuar e procedurës, gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse një përjashtim i tillë është i domosdoshëm në rrethana specifike për të mbrojtur një interes publik, dhe po ashtu duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar”¹⁰.

Nga kjo kuptohet se në bazë të standardeve që ka vendosur GjEDNj, gjykata duhet të ketë kujdes me rastin e përcaktimit nëse duhet përjashtuar publiku apo jo. Përkundër faktit se rrethanat në të cilat kjo është e mundur janë të përcaktuara taksativisht, standardet e GjEDNj përcaktojnë se këto rrethana duhet të vlerësohen drejt varësisht prej rrethanave të secilit rast. Që i bie, jo çdo pretendim apo prezencë e një elementi të tillë në një rast e arsyeton edhe përjashtimin e publikut nga një seancë gjyqësore. Po ashtu, edhe përjashtimi i publikut duhet të jetë i kufizuar deri në masën që është e domosdoshme për të arritur qëllimin e synuar. Nga kjo shihet se standardet e GjEDNj për këtë çështje janë shumë të larta, duke i dhënë rëndësi të madhe kësaj çështje.

⁶ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti GÖÇ kundër Turkisë. Aktgjykim. Strasburg. 11 korrik 2002. paragrafi 47. (Shih linkun <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-60597>). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

⁷ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Fredin kundër Suedisë. Aktgjykim. Strasburg. 23 shkurt 1994. paragrafi 21-22. (Shih linkun <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57867>). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

⁸ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Helters kundër Suedisë. Aktgjykim. Strasburg. 29 tetor 1991. Paragrafi 36. (Shih linkun <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57701>). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

⁹ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Martinie kundër Francës. Aktgjykim. Strasburg. 12 prill 2006. Paragrafi 40. (Shih linkun <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-73196>). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

¹⁰ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë. Aktgjykim. Strasburg. 17 mars 2014. paragrafi 74. (Shih linkun <https://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-139270>). (qasur së fundi më 16 maj 2019).

3. Praktikët e mbrapshta të gjykatësve të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës

Ndonëse, dispozitat ligjore si ato vendore dhe ndërkombëtare dhe po ashtu edhe praktika e GjEDNj përcaktojnë standarde të larta të aplikimit me rastin e mbylljes së një seance gjyqësore, disa gjykatës të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës rezultojnë se ende nuk e kanë parasysh rëndësinë dhe mënyrën se si funksionon kjo fushë.

Kjo për arsye se një numër i caktuar i seancave të sistemit gjyqësor që Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) monitoron, mbyllet me anë të një arsyetimi “bllanko” dhe duke e mos arsyetuar asnjë rrethanë. Vlen të theksohet se numri më i madh i seancave gjyqësore në fushën penale janë publike dhe publiku, media dhe shoqëria civile kanë qasje të papenguar. Megjithatë, IKD ka hasur në raste kur gjykatësit mbyllin seancat pa vendim me shkrim dhe nuk lejojnë praninë e mediave dhe të shoqërisë civile sidomos në seanca të caktuara gjyqësore, ku janë të përfshirë profili i lartë, për të cilat publiku ka interes të madh të informohet. Në këtë pjesë të këtij raporti do trajtojmë raste konkrete për të dy lloj praktikët e mbrapshta të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës.

Sa i përket seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë, disa prej gjykatave kanë krijuar një praktikë të kundërligjshme, duke i cilësuar këto seanca si parimisht të mbyllura, dhe duke krijuar laramani në trajtimin e kësaj çështje brenda gjykatave të Republikës së Kosovës.

Fatkeqësisht, kjo dukuri është e pranishme në sistemin gjyqësor ndër vite, dhe si e tillë, ajo ende nuk trajtohet nga aktet brenda sistemit gjyqësor, dhe për këtë arsye, shkon vetëm duke marrë çdo ditë përmasa më të mëdha.

3.1. Mbyllja e kundërligjshme e seancave publike

Më 24 prill 2019 në Gjykatën Themelore të Prishtinës është mbajtur shqyrtimi fillestar kundër 6 personave. Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë i ngarkonte të akuzuarit për kryerjen e veprave penale “privimi i kundërligjshëm i lirisë”, “shantazhi”, “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “ndihmë në kryerjen e veprës penale”. Gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, njëri nga të pandehurit ka kërkuar që gjykimi të mbahej i mbyllur dhe të përjashtohet publiku dhe mediat nga seanca, me arsyetimin se prezenca e mediave dhe publikimi i të dhënave personale mund të ndikojë keq në raportet apo pozitën e tij në jetën private. Këtij propozimi i ishin bashkangjitur edhe disa prej të akuzuarve të tjerë në këtë rast. Lidhur me këtë propozim, Prokurori i Shtetit nuk kishte dhënë mendimin e tij, por vetëm kishte deklaruar se “këtë çështje e lë në kompetencë të gjykatës”.

Gjyqtari i çështjes në këtë rast, lidhur me këtë propozim ka marrë vendim, i cili nuk përkon me aplikim të duhur të dispozitave ligjore, e aq më pak të praktikës së GjEDNj, praktikë kjo obligative sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me anë të këtij aktvendimi, Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar kërkesën që gjykimi të jetë i mbyllur për mediat dhe publikun, ndërsa ka obliguar mediat që raportimet të jenë me initiale për të akuzuarit si dhe mos të ketë fotografim të fytyrës së tyre gjatë seancës, të cilës aktvendimi i referohet si “shqyrtim gjyqësor”, ndonëse ishte duke u mbajtur shqyrtimi fillestar.

Në arsyetimin e këtij aktvendimi, kjo Gjykatë ka thënë se këtë aktvendim e ka nxjerrë duke u bazuar në nenin 294, paragrafi 1, pika 4 të KPPRK-së. Ky nen përcakton se “Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për: ... mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë”. Në bazë të po këtij neni, në aktvendim thuhet se është refuzuar kërkesa për përjashtimin e publikut dhe të mediave, ndërsa është kërkuar nga mediat që raportimet të bëhen me initiale si dhe të mos ketë fotografim të fytyrave të të pandehurëve, pasi raportimi për media do të ndikonte në jetën private të të pandehurit. Në këtë aktvendim dy (2) faqe, Gjykata pranon që pala nuk ka ofruar arsye të mjaftueshme që gjykimi të mbahet i mbyllur në tërësi për media dhe publik, por prapë se prapë ka obliguar mediat që raportimet t’i bëjnë me initiale, si dhe të mos ketë fotografim të fytyrës gjatë seancës, të cilës aktvendimi përsëri i referohet si “shqyrtim gjyqësor”.

Përball kërkesave dhe standardeve që ka përcaktuar GjEDNj, të cilat janë theksuar më lartë, arsyetimi i këtij aktvendimi përfundon me kaq.

Fillimisht, Gjyqtari nuk ka treguar se cilit nen i është referuar në rastin kur ka përcaktuar që raportimi të bëhet me initiale. Neni 294, paragrafi 1, pika 4 e KPPRK-së, të cilit i është referuar aktvendimi, nuk e jep një mundësi të tillë, por përcakton se në rastin kur plotësohen kushtet e renditura në paragrafin 1, Gjykata “mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij”, duke mos e dhënë edhe mundësinë e obligimit për media që raportimi të bëhet me initiale. Në këtë mënyrë se si është vepruar, vërehet se Gjykata vetëm sa e ka shpikur një kufizim të tillë. Ky kufizim i gjykatës nënkupton mbyllje të seancës për publikun në njërën anë si dhe për mediat në anën tjetër, të cilat janë urë lidhëse me publikun. Me anë të këtij aktvendimi, Gjykata formalisht ka vendosur që gjykimi nuk është i mbyllur, por në esencë e ka mbyllur gjykimin, duke mos i dhënë mundësi publikut që të informohet për këtë rast, ndonëse nisur nga veprat për të cilat akuzohen të pandehurit, ky gjykim është i një rëndësie të veçantë për publikun.

Sa i përket kufizimit për mos fotografimin e fytyrës së të akuzuarve, neni 301, paragrafi 3 i KPPRK-së e lejon një mundësi të tillë, ku përcakton se për këtë kufizim kërkohet aktvendim i arsyetuar me shkrim.

Për të gjitha këto, arsyetimi i aktvendimit është bërë mbi atë se “raportimi i mediave do të ndikonte në jetën private të të pandehurit”. Lidhur me këtë arsyetim, aktvendimi është kontradiktor, pasi në një rast thotë se pala nuk ka ofruar arsye të mjaftueshme ndërsa në anën

tjetër thotë se raportimi i mediave do të ndikonte në jetën e tij private. Gjykata nuk ka dhënë as edhe një fakt ose provë të vetme për të arsyetuar atë se për çfarë arsye ky raportim do të ndikonte në jetën private të të pandehurit. Përkundër kërkesave ligjore dhe standardeve të GjEDNj-së, Gjykata fare nuk ka dhënë arsyetim lidhur me peshimin në mes parimit të publicitetit të seancave, përkatësisht interesit të publikut për tu informuar lidhur me këtë rast, dhe mbrojtjes së privatësisë së të akuzuarit. Po ashtu, Gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me atë se kjo masë është më e duhura apo nëse është e domosdoshme për tu arritur qëllimi i kërkuar. Duke u nisur nga kjo logjikë, shumica dërrmuese e seancave do të duhej të mbaheshin të mbyllura, pasi një numër shumë i madh i të akuzuarve do të jepnin një pretendim të pabazuar, se raportimi i mediave për rastin e tij do të ndikonte në jetën private të tij. Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, mos publikimi i të njëjtave është obligim, pavarësisht asaj nëse ka apo nuk ka një aktvendim të një gjykate të caktuar. Si rrjedhojë, asnjë palë nuk mund të thirret në atë arsyetim.

IKD vlerëson se aktvendime të tilla më së paku paraqesin transparencë dhe llogaridhënie të sistemit gjyqësor përballë publikut. Për më tepër, aktgjykime të tilla vetëm sa e minojnë transparencën për publikun dhe paraqesin precedentin më të panevojshëm në sistemin gjyqësor. Aq më tepër kur sistemi gjyqësor, në bazë të raporteve vendore dhe ndërkombëtare, vazhdon të ketë probleme të theksuar për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies përball publikut, mediave dhe shoqërisë civile.

Po ashtu, në vitin 2016 Gjykata Themelore në Prishtinë kishte mbyllur tërësisht gjykimin ku ish-kryetari i Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, dhe tre të akuzuar të tjerë po akuzoheshin për vepra penale të korrupsionit. Po ashtu, në të njëjtin vit, e njëjta Gjykatë kishte mbyllur për publikun edhe atë që njihej si rasti më i madh nga paslufta - rasti “Stenta”. Arsyetimi i gjykatësit lidhur me mbylljen e këtij rasti kishte qenë mungesa e hapësirës së mjaftueshme, që kishte ardhur si pasojë e numrit të madh të të akuzuarve në këtë rast.

Ndaj kësaj praktike, IKD kishte reaguar më 30 nënton 2016, ku kishte vlerësuar se është e papranueshme qasja e gjykatësve të Gjykatës Themelore në Prishtinë për mbylljen e tërësishme të rastit “Mekaj” dhe mbylljen e njërit ndër rastet më të mëdha “Stenta”, të cilat përbëjnë interes të madh të publikut. Me anë të këtij reagimi publik, IKD ka kërkuar që të respektohen obligimet kushtetuese dhe ligjore për mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore për të gjitha palët në procedurë, duke përfshirë edhe informimin e publikut dhe medias në kuadër të kësaj kornize ligjore si dhe kishte kundërshtuar arsyetimet e paqëndrueshme dhe të pabazuara në kushtetutë dhe ligje për të mbyllur proceset gjyqësore për publikun dhe median për shkak të tekeve të cilitdo gjykatës. Tutje, IKD kishte shprehur zhgënjim me këtë qasje dhe mendësi të disa gjykatësve, të cilët do duhej të ishin shembull i zbatimit të dispozitave ligjore për të rritur transparencën dhe jo që të njëjtit të tentojnë të ndalojnë, kufizojnë dhe censurojnë lirinë e medias për të informuar publikun për proceset më të rëndësishme gjyqësore¹¹.

¹¹ “IKD reagon kundër mbylljes pa arsye të seancave gjyqësore”. IKD. 30 nëntor 2016. (shih linkun <https://kll-ks.org/ikd-reagon-kunder-mbylljes-pa-arsye-te-seancave-gjyqesore/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

3.2.Mbyllja arbitrare e seancave publike

Përpos rasteve të tilla si këto dy raste, ka edhe një sërë rastesh të tjera kur gjyqtarët përjashtimin e publikut dhe mediave e bëjnë në mënyrë plotësisht arbitrare, ku përjashtojnë publikun vetëm duke urdhëruar gojarisht që të largohen, dhe duke mos lëshuar fare aktvendim me shkrim, ashtu siç kërkohet nga dispozitat e KPPRK-së.

Në një rast, Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte përjashtuar nga salla mediat dhe publikun, ndërsa kur nga monitoruesit e sistemit të drejtësisë ishte kërkuar vendimi me shkrim lidhur me mbylljen dhe arsyet për mbylljen e seancës gjyqësore, e njehta kishte shprehur habi se pse po i kërkohet një vendim i tillë¹². Në seancën tjetër të rastit të njejtë, gjyqtarja e kishte hapur seancën¹³.

Në një rast tjetër, Gjyqtarja e kishte mbyllur pa vendim seancën gjyqësore, me arsyetimin se është kohë e zgjedhjeve, ndërsa i akuzuari është përfaqësues i një partie politike. Përjashtimin e publikut pa vendim, Gjyqtarja e kishte arsyetuar thjeshtë duke u bazuar në një kërkesë nga i akuzuari, pasi edhe vetë kishte thënë “Seanca është e hapur por e kam pranuar një kërkesë të tij (nga i akuzuari)”¹⁴.

Në rastin tjetër, gjatë një seance dëshmitari kishte kërkuar nga kryetarja e trupit gjykues që emri i tij dhe i kompanisë të mos përmendet, me arsyetimin se publikimi i emrave po ndikon negativisht në reputacionin e kompanisë.

Pas kësaj, kryetarja e trupit gjykues, pa vendim, kishte kërkuar që kjo kërkesë e dëshmitarit të zbatohet nga mediat dhe monitoruesit. Në këtë rast, nga monitoruesja e IKD/“Betimi për Drejtësi” është kërkuar aktvendimi me shkrim, për të cilën kërkesë kryetarja e trupit gjykues ka shprehur habi duke thënë: “A edhe juve monitoruesve me ju nxjerrë aktvendime a?”¹⁵.

Në këtë rast, dëshmitari nuk gëzon cilësinë e dëshmitarit të mbrojtur, që për të njëjtin të dhënat e tij personale dhe deklarata e tij të jenë konfidenciale dhe të mbyllura për publikun. Kurse, në këtë

¹²“Gjykatësja Lindita Jakupi pa kurrfarë sqarimi mbyll seancën për publikun në rastin e mjekut që akuzohet për trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor”. Betimi për Drejtësi. 24 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesja-lindita-jakupi-pa-kurrfare-sqarimi-mbyll-seancen-per-publikun-ne-rastin-e-mjekut-qe-akuzohet-per-trajtim-te-pandergjegjshem-mjekesor/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

¹³“Nëna thotë se gjinekologu përdori metodë të papërshtatshme gjatë lindjes së fëmijës së saj”. Betimi për Drejtësi. 2 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nena-thote-se-gjinekologu-perdori-metode-te-papershtatshme-gjate-lindjes-se-femijes-se-saj/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

¹⁴“Gjykata pa vendim mbyll seancën gjyqësore për ish-zëvendëskryeminstirin e Kosovës Sllobodon Petroviqin, shkaktar zgjedhjet”. Betimi për Drejtësi. 25 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-pa-vendim-mbyll-seancen-gjyqesore-per-ish-zevendeskryeminstirin-e-kosoves-sllobodon-petroviqin-shkaktar-zgjedhjet/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

¹⁵“Dëshmitari kërkon të mos i përmendet emri, gjykatësja pa nxjerr aktvendim u thotë mediave ta zbatojnë një kërkesë të tillë”. Betimi për Drejtësi. 12 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-kerkon-te-mos-i-permendet-emri-gjykatesja-pa-nxjerr-aktvendim-u-thote-mediave-ta-zbatojne-nje-kerkese-te-tille/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

rast as nuk ka pasur kërkesë për përjashtimin e publikut nga salla, e cila gjithashtu rregullohet me Kodin e Procedurës Penale.

Në rastin e tre të dyshuarve për përfshirjen në vrasjen e ish-liderit të iniciativës qytetare SDP në Kosovë, Oliver Ivanoviq, kur po shqyrtohej kërkesa për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake ka mbyllur gjykimin. Ndonëse interesi i publikut për tu informuar për këtë rast ishte jashtëzakonisht i madh, gjyqtari nuk kishte dhënë asnjë arsye për mbylljen e seancës, vetëm se ka njoftuar se ajo do të jetë e mbyllur¹⁶.

3.3. Gjykatësi në rolin e Prokurorit, nuk lejon xhirimin e seancës me arsyetimin se rrezikohet administrimi i drejtë i procesit gjyqësor

Më 4 korrik 2019 në Gjykatën Themelore në Pejë është caktuar seanca gjyqësore ndaj katër (4) të pandehurve. Ata akuzoheshin për veprën penale vrasje e rëndë. Në këtë seancë, ekipi “Betimi për Drejtësi”, kishte shkuar me kamera për ta xhiruar zhvillimin e kësaj seance.¹⁷ Kryetari i trupit gjykues, nuk kishte lejuar xhirimin e seancës me kamera, duke sugjeruar që për seancat e radhës të bëhet kërkesë me shkrim për të lejuar xhirimin e seancave. Ekipi IKD/“Betimi për Drejtësi” në përputhje me obligimet ligjore që rrjedhin sipas Kodit të Procedurës Penale, nuk ka bërë kërkesë, sipas sugjerimit të gjykatësit, por vetëm e ka njoftuar atë se në të gjitha seancat e radhës, monitorimi i seancave do të bëhet edhe me kamera, duke incizuar seancat.¹⁸ Më 10 korrik 2019, Kryetari i trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Pejë, duke ju përgjigjur njoftimit të ekipit të IKD-së/“Betimi për Drejtësi”, ka nxjerrë Aktvendim me shkrim, përmes të cilit ka vendosur që të **ndalojë** regjistrimin (audio-video) e seancave të shyrtimit gjyqësor të caktuara për tu mbajtur në datat 23, 24, 25, dhe 26 shtator 2019, ndërsa ka **lejuar** regjistrimin (audio-video) të seancës së shyrtimit gjyqësor të datës 3 tetor 2019.

Në arsyetimin e këtij aktvendimi, Kryetari i trupit gjykues, shkruan se Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda – është në procedurë e sipër të çështjes penale ndaj katër të pandehurve të akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe 1.8 lidhur me nenin 34 paragrafi 1 i Kodit Penal.

Në aktvendim shkruan se “Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar seancat e shqyrtimit gjyqësor me datat 23.09.2019, 24.09.2019, 25.09.2019, 26.09.2019 dhe 03.10.2019.”

¹⁶ “Mbyllet seanca dëgjimore ndaj tre të dyshuarve për vrasjen e Oliver Ivanoviqit”. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbyllet-seanca-degjimore-ndaj-tre-te-dyshuarve-per-vrasjen-e-oliver-ivanoviqit/>). (Qasur për herë të fundit më 16 maj 2019).

¹⁷ “Gjykimi për vrasje, gjykata s’lejon që avokati i dëshmitarit bashkëpunues të jetë mbrojtës i njërit nga të akuzuarit”. 4 korrik 2019. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun [https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-vrasje-gjykata-s-lejon-qe-avokati-i-deshmitarit-bashkëpunues-te-jete-mbrojtes-i-njerit-nga-te-akuzuarit/](https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-vrasje-gjykata-s-lejon-qe-avokati-i-deshmitarit-bashkepunues-te-jete-mbrojtes-i-njerit-nga-te-akuzuarit/)). (Qasur për herë të fundit më 30 korrik 2019).

¹⁸ Monitoruesi i IKD-së/“Betimi për Drejtësi” më 9 korrik 2019, ka njoftuar Kryetarin e Trupit Gjykues të Gjykatës Themelore në Pejë se seancat e radhës që janë publike në këtë shqyrtim gjyqësor do të monitorohen dhe do të xhirohen me kamera.

Tutje, Kryetari i trupit gjykues, shkruan se nga IKD, ka pranuar një parashtresë, përmes të cilës është njoftuar se seancat e radhës do të monitorohen dhe xhirohen me kamera.

Në vazhdim të arsyetimit të aktvendimit për ndalimin e xhimit të seancave me kamera, shkruan se:

“Kryetari i trupit gjykues vlerëson se duke e pasur parasysh se shqyrtimi gjyqësor ka arritur në fazën ku të pandehurit do ta japin mbrojtjen e tyre lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen e meqenëse të katër të pandehurit akuzohen se veprën penale e kanë kryer në bashkim kriminal, incizimi i tyre gjatë dhënies së dëshmisë do të mund të ndikojë në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Gjykata ka planifikuar që të pandehurit të deklarohen në seancat e caktuara me datat 23.09.2019, 24.09.2019, 25.09.2019, 26.09.2019, ashtu që secili prej tyre do ta japë mbrojtjen në ditë të ndryshme andaj, meqenëse të pandehurit akuzohen për një veprë penale të natyrës së rëndë dhe dënimi i paraparë për këtë veprë është mjaftë i lartë, ekziston rreziku që incizimi i deklaratës së një të pandehuri të keqpërdoret në drejtim të bashkërendimit të mbrojtjes mes tyre e me këtë të pengohet arritja e qëllimit të gjykimit.

Shqyrtimi gjyqësor do të vazhdojë më datën 03.10.2019, për kur është planifikuar që të jepet fjala përfundimtare nga ana e palëve në procedurë, në seancën e kësaj date lejohet filmimi.

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 3 ditësh në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e nëpërmes kësaj Gjykate.”¹⁹

Sipas KPPRK roli i gjyqtarit dhe i palëve ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Roli i gjyqtarit ka ndryshuar në më pak proaktiv gjatë procedurave, ndërsa mbrojtja dhe prokuroria kanë më shumë përgjegjësi. Prokurori ka detyrë më të madhe për zhvillimin dhe prezantimin e provave (**“rasti i prokurorisë”**). Në anën tjetër, mbrojtja siguron që prokurori ka vepruar si duhet dhe që i ka prezantuar provat e siguruar ligjërisht dhe ka ngritur aktakuzë të bazuar në ligj. Sipas KPPRK, mbrojtja gjithashtu ka mundësinë për të kërkuar prova që mbështesin pozitën e të pandehurit, siç janë alibitë apo provat të cilat tregojnë se i pandehuri nuk ka pasur motiv për të kryer veprën. (**“rasti i mbrojtjes”**). Megjithatë, **gjyqtari mbetet “mbrojtësi i të drejtave” dhe ka detyra të reja të qarta për të mbrojtur të drejtat e palëve.**²⁰

Prandaj, është thelbësore që gjyqtari të ndërhyjë dhe të sigurojë barazinë e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas KPPRK, ndonëse roli i gjyqtarit është shndërruar nga një rol shumë

¹⁹ Sqarim: IKD nuk ka bërë ankesë ndaj këtij aktvendimi, sipas këshillës juridike të bërë në këtë aktvendim nga Gjykata Themelore në Pejë. Ankesa nuk është bërë për shkak se në bazë të KPPRK-së, ankesa ndaj aktvendimit për përjashtimin e publikut nuk lejohet fare. Paragrafi 2 i nenit 296 të KPPRK-së që flet për aktvendimin për përjashtimin e publikut përcakton decidivisht se “Aktvendimi për mbajtjen e seancës së mbyllur mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit”. Në kuptim të nenit 384.1.4 të KPPRK-së, ankesa ndaj këtij aktvendimi lejohet vetëm në momentin e paraqitjes së ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, dhe jo edhe ndaj aktvendimit të nxjerrë gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor.

²⁰ Raporti i OSBE-së, lidhur me Shqyrtimin e zbatimit të Kodit të ri të Procedurës Penale në Kosovë. Qershor 2016.

proaktiv në një rol më pak aktiv gjatë procedurës, ai vazhdon të jetë “garantues i të drejtave” dhe ka detyrime të reja eksplicite për mbrojtjen e të drejtave të palëve.²¹

Prandaj, duke pasur paraysh këto që u thanë më sipër, IKD vlerëson se Kryetari i trupit gjykues në këtë rast të Gjykatës Themelore në Pejë, ka marrë aktvendim, i cili nuk përkon me aplikim e duhur të dispozitave ligjore, e aq më pak të praktikës së GjEDNj, praktikë kjo e zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.

IKD vlerëson se ky aktvendim është paradoksal për shkak se nuk ndalon monitorimin dhe raportimin në publik të të gjitha detajeve të këtyre seancave të këtij rasti, por e ndalon vetëm incizimin me kamera. Nëse do të ekzistonte arsyeshmëria që nga këto seanca të mos bëhen publike detajet e dëshmisë së të pandehurve, për shkak të mundësisë së koordinimit të deklaratave të tyre, atëherë logjikisht kjo do duhej të parandalohej përmes mbylljes së tërësishtme të seancave për publikun dhe mediat. Në të kundërtën, arsyetimi i qëllimit të gjykatës për ta arritur qëllimin e gjykimit, në të cilin është thirrur në aktvendim, assesi nuk mund të qëndrojë. Xhirimi apo filmimi i seancës, nuk do të mund të shpërfaq më shumë informacion, sesa raportimi i të gjitha detajeve që bëhet nga monitoruesit dhe gazetarët, përjashtoj pamjet dhe dëshmitë e drejtpërdrejta të të pandehurve që do të mund të shfaqeshin përmes kamerave. Pra, si arsyetim, IKD vlerëson se nuk qëndron sepse nuk ka logjikë të ndalohej xhirimi apo filmimi e të mos ndalohej në tërësi seanca, informatat prej të cilës, nëse publikohen do të mund ta rrezikonin në çfarëdo mënyrë administrimin e drejtësisë për një gjykim të drejtë.

Po ashtu, në këtë aktvendim, gjyqtari arsyetimin për mbylljen e seancës nuk e ka ndërlidhur me asnjë prej 6 rasteve taksative në të cilat sipas nenit 294 të KPPRK lejohet përjashtimi i publikut.

Për më tepër, IKD vlerëson se në këtë rast, Kryetari i trupit gjykues ka ndërruar rolin e tij prej arbitri. Përkujdesja e arbitrit në këtë rast, ngjan sikurse në rolin e prokurorit, i cili në fazën e procedimit të hetimit penal, zhvillon strategji të hetimit të mirëfilltë për të parandaluar çfarëdo pengese apo koordinimi në mes të pandehurve dhe deklarimeve të tyre që do ta pengonin zbardhjes e së vërtetës, rrjedhimisht zbulimin e kryerësve të veprës penale. Kjo çështje i takon prokurorit, ndërsa gjykatësi, sikurse përcaktohet në sistemin e drejtësisë penale, të cilin e mishëron Republika e Kosovës, luan ekskluzivisht rolin e arbitrit, në administrimin e drejtë të provave dhe dëshmive, të cilat ofrohen nga palët e përfshira në një procedurë penale.

Ndryshe, Prokuroria Themelore e Pejës ndaj të pandehurve ka zhvilluar hetimet penale, ka marrë deklaratat e të tyre në procedurën paraprake dhe të hetimit penal, e cila procedurë ka qenë e mbyllur dhe ka shërbyer për provimin e fakteve lidhur me kryrjen e veprës penale, ndërsa deklarimi në shqyrtim gjyqësor nga ana e të pandehurve, sikurse në të gjitha rastet tjera, manifestohet me rrëfime, ballafaqime, pyetje të cilat parimisht bëhen drejtpërsëdrejti në seancë publike, në mënyrë që të bëhet administrimi i tyre në mënyrë të drejtë dhe publikisht që qytetari të bindet në vendimet që merren prej gjykatës. Në të kundërtën, për shkak të specifikave të tjera,

²¹ Po aty.

siç parashihet me dispozita të KPPRK-së, në rastet kur vlerësohet se ka arsye të qëndrueshme për ta administruar si duhet një proces gjyqësor, seancat mund të mbyllen për publikun në tërësi apo vetëm pjesërisht.

Prandaj, IKD vlerëson se aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë nuk është i bazuar në dispozita ligjore dhe për më tepër nuk është i balancuar mirë me interesat e parimit të publicitetit për një sistem gjyqësor transparent të një shoqërie demokratike në një anë dhe shkaqeve të dëmtimit të interesave të drejtësisë.

Transparenca dhe publiciteti gjatë procedurave gjyqësore janë elemente substanciale, të cilat ndikojnë në ngritjen e besimit të qytetarëve në drejtësi dhe i japin kuptim administrimit të drejtësisë.

Për më tepër, transparenca në administrimin e drejtësisë kontribuon në sigurimin e një gjykimi të drejtë, duke krijuar mundësi që mediat të ushtrojnë rolin e tyre që kanë si kontrollues publik.

3.4.Praktika e kundërligjshme e disa gjykatave për përjashtimin e publikut nga seancat dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë

Sa i përket procedurës paraprake, nga monitorimi sistematik që IKD bënë në sistemin e drejtësisë, është parë se në disa gjykata është krijuar si praktikë që të gjitha seancat dëgjimore në të cilën shqyrtohen kërkesat për masa të sigurisë të jenë të mbyllura. Kjo praktikë nuk ka bazë ligjore, dhe e njejta paraqet një arbitrarizëm të sistemit gjyqësor. Neni 188 i KPPRK-së përcakton se “...gjyqtari i procedurës paraprake zbaton seancën dëgjimore mbi paraburgimin”... Në këtë rast, askund nuk përmendet se publiku dhe mediat nuk mund të jenë të pranishëm në seancë dëgjimore. Sa i përket mbylljes së procedurës paraprake për publikun dhe mediat, kjo përcaktohet në disa raste të tjera specifike, siç është neni 85 i KPPRK-së që përcakton procedurën për fshehtësinë e mbledhjes së informatave. Në këto raste, përcaktohen rrethanat dhe kushtet për mbylljen e dosjes. Nga kjo kuptohet se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përcakton se seanca dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë janë të mbyllura, çka nënkupton se kjo praktikë e ndërtuar nga disa gjykata është tërësisht arbitrare. Për më tepër, kjo praktikë nuk ndiqet nga të gjitha gjykatat, por në disa prej tyre.

IKD vlerëson se këto praktika të mbrapshta dhe të kundërligjshme vetëm sa shpërfaqin mungesën e transparencës dhe llogaridhënës së disa gjykatësve të sistemit gjyqësor përball publikut, mediave dhe shoqërisë civile. Praktika të tilla janë plotësisht arbitrare, dhe në kundërshtim me deklaratimet që akterët e sistemit gjyqësor proklamojnë vazhdimisht. Po ashtu, çdo mbyllje e seancës si në rastet e sipërpërmendura paraqet një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm për transparencën e sistemit gjyqësor përballë publikut, mediave dhe shoqërisë civile, dhe në këtë formë krijohet një ortek i mos transparencës, dhe mund të shndërrohet në fenomen, nëse vazhdon të thellohet edhe më shumë me raste të reja.

4. Mbyllja e gjyqimeve si demantim i premtimit dhe të arriturave për transparencë

Krerët e sistemit gjyqësor por edhe vetë gjykatësit vazhdimisht proklamojnë se në punën e tyre ata janë maksimalisht transparent përballë publikut, mediave dhe shoqërisë civile. Në çdo paraqitje të tyre publike, transparenca është kryefjala e tyre, duke shtuar se sistemi gjyqësor tanimë është një sistem me transparencë po thuajse të plotë.

Në të gjitha koncept dokumentet e kryetarëve të gjykatave, mbi bazën e të cilave të njëjtit janë zgjedhur në këto pozita, të njëjtit zotohen se gjatë mandatit të tyre, puna e tyre do të zhvillohet mbi bazën e transparencës dhe llogaridhënies së plotë përballë publikut, mediave dhe shoqërisë civile.

Po ashtu, në secilin raport të përpiluar, gjykatat thonë se në periudhën respektive, gjykata ka qenë maksimalisht transparente. Të njëjtën e thonë edhe gjithë kryetarët e gjykatave gjatë raportimeve para anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për punën e tyre për periudha të caktuara.

Por, për gjetje të shumta të raporteve vendore dhe ndërkombëtare, të njëjtit nuk kanë përgjigje. IKD përmes raporteve periodike vazhdimisht ka identifikuar fusha jashtëzakonisht specifike ku gjykatësit e sistemit gjyqësor kanë dështuar që të jenë transparent në disa raste. Po ashtu, mungesën e transparencës në disa raste me interes për publikun e dëshmon edhe ky raport, me rastet e sipër përmendura.

Sikurse ky raport, ashtu edhe raportet paraprake të IKD-së, por edhe raportet e tjera ndërkombëtare dëshmojnë se sistemi i drejtësisë, sidomos në raste të caktuara që përbëjnë interes të madh të publikut vazhdon të mos jetë transparent. Për këtë arsye, IKD i bënë thirrje të gjithë akterëve të sistemit të drejtësisë që t'i realizojnë premtimet e tyre të vazhdueshme për transparencë dhe të mos lejojnë asnjë lloj arbitrariteti me rastin e mbylljes së seancave nga gjykatësit.

5. Heshtja e akterëve të sistemit të drejtësisë përballë këtij fenomeni

Ndonëse nga mediat dhe shoqëria civile raportohet për raste të shumta të mbylljes së kundërligjshme dhe arbitrare të seancave gjyqësore për të cilat publiku është i interesuar të informohet, të gjithë akterët brenda sistemit të drejtësisë heshtin përballë këtyre dukurive.

IKD bënë me dije se fakti se një gjyqtar i caktuar ka pavarësi në vendosje dhe është *dominis litis* në një lëndë, nuk e bënë atë imun ndaj vendimeve të kundërligjshme për mbylljen e seancave që me ligj janë publike, e aq më tepër ndaj rasteve kur të njëjtit përjashtojnë publikun dhe mediat në mënyrë plotësisht arbitrare, pa marrë asnjë lloj vendimi.

Sa i përket raporteve periodike të gjykatave, por edhe të vetë KGJK-së, tanimë është bërë praktikë që të njëjtat të jenë vetëm përshkruese dhe assesi analitike, në atë mënyrë që të përshkruajnë sfidat dhe problemet e identifikuara, si dhe qasja e gjykatave për zgjidhjen e këtyre

problemeve. Një fat të tillë e ka edhe dukuria e mbylljes së seancave në mënyrë të kundërligjshëm dhe arbitrare.

Për këto arsye, është kërkesë imediate dhe urgjente që KGJK në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës, të trajtojë këtë çështje dhe të marrë masat adekuate që të ndalet ky fenomen. Në këtë drejtim, rol të rëndësishëm konsultativ mund të japë edhe Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Në anën tjetër, rëndësia e publicitetit të seancave dhe logjika e arsyetimit të aktevevendimeve për mbyllje të seancave duhet të jetë pjesë e trajnimit që Gjyqtarët ndjekin në Akademinë e Drejtësisë (AD).

6. Konkluzione

- Parimisht, secila seancë gjyqësore është e hapur për publikun, mediat dhe shoqërinë civile. Rastet kur të njëjtat mbyllen janë raste përjashtuese, rrethanat për të cilat raste janë të përmendura taksativisht në KPPRK.
- Për rrethanat e përmendura në KPPRK për të cilat mund të mbyllet gjykimi për publikun, mediat dhe shoqërinë civile, nuk është e mjaftueshme që në aktvendimet e gjykatave vetëm të citohet në mënyrë “blanko” ajo rrethanë, por ajo rrethanë duhet të arsyetohet përmes provave në mënyrë të thukët, në kuptim që përmes një aktvendimi të tillë të krijohet besimi edhe tek vetë publiku se mbyllja e një seance të caktuar është një veprim ligjor dhe i drejtë.
- Përjashtimi i publikut, mediave dhe shoqërisë civile pa asnjë vendim të shkruar, më së paku paraqet arbitrarizëm.
- Në bazë të KPPRK-së, parimisht, seancat dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë janë të hapura. Për këtë arsye, praktika laramane e krijuar brenda sistemit gjyqësor, ku në disa gjykata janë publike ndërsa në disa gjykata të mbyllura, është e papranueshme. Lidhur me këtë laramani të krijuar, edhe KGJK ka obligim që të disiplinojë gjyqtarët në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore.
- Përkundër faktit se është gjyqtari që nxjerrë vendim nëse një seancë do të jetë publike apo e mbyllur, në kuptim të administrimit të mirë të drejtësisë kontribut duhet të japin edhe prokurorët. Në këtë drejtim, të njëjtë duhet të angazhohen që në rastet kur një kërkesë për mbyllje të një seance nuk ka bazë ligjore, prokurorët duhet ta kundërshtojnë të njëjtën. Po ashtu, në rastet kur seancat mbyllen në kundërshtim me ligjit, prokurorët duhet të atakojnë këtë vendim me ankesë në Gjykatën e Apelit, me rastin e parashtrimit të ankesës ndaj aktgjykimit përfundimtar.
- Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë për detyrim që të vendosin standarde ligjore dhe të drejta në trajtimin e lëndëve. Nisur nga ky detyrim, edhe sa i përket mbylljes së seancave publike në kundërshtim me ligjin, Gjykata e Apelit duhet të jetë aktive në këtë fushë dhe të vendosë standarde të drejta dhe ligjore, në atë mënyrë që të filtrojë dhe të mos lejojë që aktgjykime të nxjerra jashtë syve të publikut në kundërshtim me ligjin të bëhen të plotëfuqishme.
- Publiciteti i seancave gjyqësore duhet të kuptohet në atë formë që në asnjë rrethanë nuk e dëmton administrimin e drejtësisë. Në të kundërtën, siç e përcakton edhe praktika e GjEDNj, ajo i mbron palët ndërgjygjëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur dhe është një nga mënyrat me anë të së cilës mbahet besimi në gjykata.
- Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se publiciteti i seancave gjyqësore, sipas KEDNj, është një nga elementet që formëson të drejtën për një proces të rregullt.
- Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, aktgjykimet e GjEDNj janë të obligueshme për tu zbatuar në secilin rast. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të njëjtë duhet ti referohen praktikës së kësaj gjykate

dhe të aplikojnë standardet që e njëjta ka vendosur, me rastin e shqyrtimit të një kërkesë për mbylljen e seancës.

- Transparenca e sistemit të drejtësisë nuk është një fakt i mirëqenë, i cili mund të proklamohet në mënyrë të përgjithësuar. Për vlerësimin e transparencës, ka matës shumë specifik. Sa i përket sistemit gjyqësor, mos transparenca më e madhe paraqitet në rastet kur publiku përjashtohet nga përcjellja e seancave gjyqësore të cilat sipas ligjit janë të hapura, dhe për të cilat publiku ka interes që të informohet.

7. Rekomandime

- Gjyqtarët të rishqyrtojë vendimet e tyre për mbylljen e seancave.
- Gjyqtarët ta trajnohen për të kuptuar drejtë qëllimin për mbajtjen publike të seancave gjyqësore.
- Vendimet për mbylljen e seancave të jenë të arsyetuara konform kërkesave ligjore dhe standardeve të përcaktuara nga GjEDNJ dhe për këtë fushë ata duhet të trajnohen vazhdimisht. Pas zhvillimit të trajnimeve, KGJK duhet të monitorojë zbatimin e praktikës së GjEDNJ-së dhe gjyqtarët që nuk shkojnë në këtë linjë, duhet t'i thërrasë në përgjegjësi disiplinore.
- Gjyqtarët në asnjë rast të mos përjashtojnë publikun, mediat dhe shoqërinë civile nga seancat, pa marrë një aktvendim të shkruar dhe të arsyetuar mirë.
- Parimisht, të gjitha seancat dëgjimore për shqyrtimit e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë të jenë të hapura për publikun.
- Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme të përcaktojnë praktika të drejta gjyqësore lidhur me hapjen dhe mbylljen e seancave për publikun, mediat dhe shoqërinë civile.
- Prokurorët të kundërshtojnë kërkesat e pabazuara për mbylljen e seancave gjyqësore. Në rastin kur konsiderojnë se vendimet për mbylljen e seancave kanë qenë të kundërligjshme, të njëjtit t'i atakojnë aktgjykimet në Gjykatën e Apelit sa i përket kësaj pjese.
- KGJK të reagojë konform mandatit të saj për të disiplinuar gjyqtarët që të njëjtit t'i përmbahen obligimeve ligjore në rastin kur vendosin lidhur me hapjen dhe mbylljen e seancave për publikun, mediat dhe shoqërinë civile.
- KGJK të trajtojë laramaninë e krijuar lidhur me hapjen për publikun të seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurisë.
- Në drejtim të adresimit sa mirë të kësaj teme, kontribut të jap edhe Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.
- Akterët e sistemit të drejtësisë të zbatojnë premtimet e tyre të vazhdueshme për transparencë dhe llogaridhënie të sistemit të drejtësisë përballë publikut, mediave dhe shoqërisë civile.